



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:185105

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05400142

PPP.nr.470/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Ibrahim Maloku, në çështjen juridike përmbaremore ndërmjet kreditorit Inspektorati Shëndetësor i Kosovës me seli në Prishtinë, kundër P. T nga Glllogoci, të cilën e përfaqëson Zyra Ligjore Pro Juris me avokatët Arbër Krasniqi dhe Agnez Furra me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbaremore përmbushje e gjobës, vlera 1,000.00€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitorja, kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit numër P.nr.176/22, të datës 10.11.2022, të lejuar nga Përmbareusi Privat Isa Shala në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorës P.T nga Glllogoci, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit P.nr.176/22, të datës 10.11.2022, të lejuar nga Përmbareusi Privat Isa Shala në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbareusi Privat Isa Shala në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorës Inspektorati Shëndetësor i Kosovës me seli në Prishtinë, ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përmbareimin në bazë të Vendimit Nr.10/AR-125-21, të datës 01.11.2021, me të cilin debtoja është obliguar që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 1,000.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareimore sipas tarifës së përmbareuesve nën kërcënimin e përmbaremit të dhunshëm me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogari bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbareuesit, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe pagesa e kërkuar në para për kreditorin.

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit, brenda afatit ligjor, debitorja ka paraqitur prapësim për shkak se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbareues ose urdhri përmbareues nuk është i përshtatshëm për përmbareim në bazë të LPP-së. Ka theksuar se urdhri për përmbareim P.nr.176/22, është marrë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, ngase i njëjti nuk është i rregullt

dhe nuk plotëson kërkesat e me nenit 71 par.1.1 të LPP-së, ngase është bërë aplikim i gabuar i të drejtës materiale, me të cilin janë shkelur dispozitat procedurale dhe është bërë vërtetim i gabuar i gjendjes faktike. Tutje ka theksuar se sipas LPP-së, nenit 24 par.3 parashihet: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbardimor, po që se si i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”*. Në këtë kuptim lidhur me dispozitivin e sqarojnë Gjykatës se kanë bërë padi për inicimin e konfliktit administrativ, për anulimin dhe shpalljen e pavlefshme të vendimit nr.10/AR-125-21, i datës 01.11.2021, si dhe vendimit Nr.10/K-076/21, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative. Ka shtuar se me paraqitjen e padisë vendimi bëhet i papërmbardueshëm, duke mos i plotësuar tiparet e përmbardueshmërisë deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Po ashtu ka theksuar se kreditori nuk është dashur që të shkon në procedurë përmbardimore për realizimin e mjeteve, pa marrjen e një vendimi në procedurë administrative nga Gjykata, ngase vendimi i marr nga Inspektorati i Shëndetësisë është enë kundërshtim të plotë me ligjin dhe i njëjti nuk mund të jetë i përmbardueshëm. Nga këto arsye ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovet dhe të anulohet urdhri për përmbardim P.nr.176/22, dt.09.11.2022.

Kreditorja përgjigje në prapësim nuk ka ushtruar.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorës të paraqitura në prapësim, si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i pa bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, e cila përcakton llojet e dokumenteve përmbarduese, në nënpar 1.2 parasheh që: *“Dokumente përmbarduese janë: vendimi përmbardues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*. Tutje, dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbardimor, po që se si i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbardimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbardim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbardimor është i përshtatshëm për përmbardim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbardjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, në mënyrë që dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbardimi t'i njihet cilësia e dokumentit të përshtatshëm për përmbardim.

Në rastin konkret, përmbardimi është lejuar në bazë të të Vendimit Nr.10/AR-125-21, të datës 01.11.2021. Nga vlerësimi i këtij dokumenti, Gjykata gjen se i njëjti paraqet vendim të dhënë në procedurë administrative, si dhe përmban të dhëna për kreditorin, debitorin, objektin, mjetet, shumën dhe kohën e përmbardjes së detyrimit dhe si i tillë i përmbardhë të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara nga nenet 22, 24 dhe 27 të LPP-së për tu konsideruar i përshtatshëm për përmbardim, në kuptim të dispozitës nga neni 21 të LPP-së, e cila parasheh që: *“Organi përmbardues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbardimin vetëm në bazë të dokumentit përmbardues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata me rastin e vendosjes trajtoi pretendimet e ngritura nga ana e debitorit lidhur me faktin se kundër vendimit në fjalë kanë inicuar procedurën e konfliktit administrativ pran Gjykatës Themelore në Prishtinë me datën 21.12.2021.

Lidhur me këto pretendime, Gjykata iu referua Ligji Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor, përkatësisht dispozitës së nenit 11 par.4 të të njejtit, ku përcaktohet: *“Ankesa e ushtruar në vendimin e inspektorit shëndetësor nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.”*. Në kontekst të njejtë, dispozita nga neni 24 par.5 e LPP-së parasheh që: *“Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin”*. Kurse me dispozitën e nenit 22 par.1 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative shprehimisht përcaktohet se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.”*.

Në bazë të interpretimit të këtyre dispozitave, Gjykata vlerëson se fakti që palët kanë pasur të drejtën e ankesës ndaj vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi dhe se kundër vendimit përfundimtar është inicuar edhe procedura e konfliktit administrativ përmes padisë së datës 21.12.2021, nuk paraqet kurrfarë pengese për caktimin e përmbarimit duke iu referuar vendimit në fjalë, pasi dispozitat e lartëcekura janë të karakterit përjashtues dhe si të tilla ua japin cilësinë e dokumentit përmbarues, siç ka ndodhur në rastin konkret. Për më tepër debitorja me prapësimin e ushtruar nuk ka bashkangjitur ndonjë provë me anë të së cilës vërtetohet se kanë kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ mbi bazën e të cilit është inicuar procedura përmbarimore, ashtu sikurse përcaktohet me nenin 22 par.2 të LKA-së, dhe po ashtu nuk kanë paraqitur prova se një kërkesë e tillë është aprovuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative. Bazuar në një vlerësim të tillë, Gjykata pretendimet e parashtrura nga ana e debitorit i vlerëson si të pa bazuara dhe rrjedhimisht pa ndikim në një vendosje ndryshe e cila do të rezultonte me aprovimin e prapësimin dhe anulimin e Urdhërit Përmbarimor. Mbi këtë bazë, vendosi si në dispozitivin të këtij aktvendimi, duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi Urdhërin Përmbarimor të goditur me prapësim.

Mbi bazën e arsyeve të lartëcekura, në kuptim të dispozitës nga neni 73 par.3 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
PPP.nr.470/23, datë 01.03.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.